Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion lidhur me hartimin dhe miratimin e vendimit të Këshillit të Ministrave që përcakton masën e shtesës për natyrë të veçantë pune dhe kriteret për përcaktimin e saj për koordinatorët për të drejtën e informimit, bëjmë me dije sa më poshtë vijon:

Në këndvështrim të procedurës ligjore që ndiqet për përgatitjen e projektvendimeve të Këshillit të Ministrave në fushën e pagave, sqarojmë se, referuar shkronjës "a", të pikës 4, të nenit 8, të ligjit nr. 35/2023, "Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi", të ndryshuar, këto projektvendime vlerësohen dhe përgatiten kryesisht nga Departamenti i Administratës Publike (DAP), vetëm në rastin e rritjeve apo reformës së përgjithshme të pagave, bazuar në disponueshmërinë e fondeve përkatëse të vëna në dispozicion nga ana e ministrisë përgjegjëse për financat.

Në të gjithë rastet e tjera, referuar shkronjave "c", "ç" dhe "d", të pikës 4, të nenit 8, të ligjit të sipërcituar, projektvendimet e Këshillit të Ministrave vlerësohen dhe përgatiten nga DAP, pas kërkesës/propozimit përkatës të: i) Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, për Kryeministrinë dhe institucionet në varësi të Kryeministrit, ii) ministrit përkatës, për ministritë e linjës dhe institucionet në varësi të ministrit, si dhe iii) titullarëve të institucioneve të pavarura, organeve drejtuese të njësive të vetëqeverisjes vendore apo Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore.

Gjatë procesit të hartimit të projektvendimeve të pagave, DAP-i i bashkërendon ato me ministrin përgjegjës për financat për sa u përket efekteve të tyre financiare, në zbatim të pikës 3, të nenit 8, të ligjit nr. 35/2023.

Propozimi për masën e shtesës për natyrë të veçantë pune, për nëpunësit në rolin e koordinatorit për të drejtën e informimit në institucionet shtetërore është përcjellë në DAP, nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me shkresën nr. 1456, datë 23.05.2025. Propozimi i Komisionerit parashikonte shtesë të shkallëzuar për koordinatorët e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për koordinatorët për të drejtën e informimit në aparatet e ministrive të linjës dhe institucionet qendrore, si dhe për koordinatorët në institucionet e tjera.

Ky propozim u shqyrtua nga Departamenti i Administratës Publike dhe u përfshi në projektvendimin përkatës për ndryshimin e vendimit nr. 325, datë 31.5.2023 të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike", të ndryshuar, në dhjetor 2025 - janar 2026, në kuadër të procesit të indeksimit të pagave për të gjithë nëpunësit/punonjësit e institucioneve të administratës publike, dhe u dërgua për bashkërendim në Ministrinë e Financave.

Ministria e Financave nuk shprehu dakordësinë që ky propozim të bëhej pjesë e VKM-së nr. 325/2023, të ndryshuar, duke argumentuar se këto shtesa nuk ishin përfshirë në përllogaritjet e

kalkuluara në koston e indeksimit të pagave dhe se duhet të paraqiten paraprakisht në fazën e hartimit të buxhetit për vitet 2027-2029.

Si përfundim, ju sqarojmë se, kërkesa juaj për informim është regjistruar në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve 2026 të DAP-it, me numrin rendor 30, sipas detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", të ndryshuar.

Për çdo kërkesë tjetër për informim ju mund t'i drejtoheni adresës së kontaktit info@dap.gov.al.

Duke ju falenderuar,